

Ukraina dhe ShBA-ja
nënshkruajnë marrëveshje për
mineralet, krijojnë Fond
Investimesh për Rindërtim

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

S'KA KONSTITUIM TË KUVENDIT AS NË PËRPJËKJEN E NËNTË



Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar ta konstitudojnë Kuvendin e Kosovës të enjten, në përpjekjen e nëntë, pasi nuk kaloi propozimi i kryesuesit

të seancës, Avni Dehari, për votim të fshehtë për kryeparlamentarin. Ndryshe nga herët e kaluara, nuk u propozua kandidati për kryetar të Kuvendit nga

partia fituese e zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje. Përpjekja e radhës për konstituimin e Kuvendit të Kosovës do të bëhet të shtunën e 3 majit

VERRAT E LLUKËS MBETEN KUJTESË DHE FRYMËZIM PËR BREZAT QË VIJNË F. 3



KURTI VIZITON DREJTORIN E QKUK-së OSMAN HAJDARIN, DËNON SULMIN NDAJ TIJ F. 6



AKTUALE



KROACIA: SHTETE TË BE-së E NATO-s MUND T'I BASHKOHEN ALEANCËS USHTARAKE, VEÇMAS ATA QË DUAN T'U JAPIN PËRKRAHJE KOSOVËS E SHQIPËRISË F. 3

AVOKATI I POPULLIT I KËRKON ZRRE-SË T'I PEZULLOJË VENDIMET PËR RITJEN E ÇMITIT TË RRYMËS F. 6

EKONOMI



PUNËTORËT NË KOSOVË PROTESTOJNË PËR TË DREJTAT E TYRE, KËRKOJNË RITJEN E PAGAVE F. 7

TË RINJTË E KOSOVËS PËRBALLË PAPUNËSISË: DIPLOMA NË DORË, PUNË NË SEKTORË TË TJERË F. 7

SPORT



KASTRIOTI MPOSHTI BESËN PAS VAZHDIMEVE F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina dhe ShBA-ja nënshkruajnë marrëveshje për mineralet, krijojnë Fond Investimesh për Rindërtim

UASHINGTON, 1 MAJ - Shtetet e Bashkuara dhe Ukraina kanë nënshkruar një marrëveshje që i jep ShBA-së qasje në mineralet e rralla me vlerë të lartë të Ukrainës - një marrëveshje që Kiev shpreson se do ta sigurojë vazhdimësinë e mbështetjes amerikane në luftën kundër Rusisë.

Marrëveshja krijon Fondin e Investime për Rindërtim ShBA - Ukrainë, për të cilin Departamenti i Thesarit të ShBA-së tha se do t'u mundësojë të dyja vendeve të "punojnë bashkërisht dhe të investojnë së bashku për të siguruar që asetet, talentet dhe kapacitetet tona të përbashkëta të përshpejtojnë rimëkëmbjen ekonomike të Ukrainës".

Sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent, deklaroi në një komunikatë për media se marrëveshja "është një sinjal i qartë për Rusinë se administrata Trump është e përkushtuar ndaj një procesi paqeje të bazuar në një Ukrainë të lirë, sovranë dhe të begatë në afat të gjatë".

Bessent e quajti themelimin e Fondit për Investime një partneritet ekonomik historik, dhe ia atribuoi presidentit amerikan, Donald Trump, nxitjen për nënshkrimin e marrëveshjes si pjesë e përpjekjeve të tij për t'i dhënë fund luftës. "Siç ka thënë presidenti, Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara të ndihmojnë në ndërmjetësimin për përfundimin e kësaj lufte mizore dhe të pakupimte", shtoi Bessent.

Trumpi është shprehur i pakënaqur me ritmin e ngadaltë të bisedimeve. Më 29 prill, Departamenti i Shtetit i ShBA-së bëri një tjetër

përpjekje për të nxitur përparim, duke paralajmëruar se ShBA-ja mund të tërhiqet nga negociatat në mungesë të progresit.

Ministrja e Ekonomisë dhe zëvendëskryeministrja e Ukrainës, Yulia Svyrydenko, e nënshkroi marrëveshjen së bashku me Bessentin, sipas Departamentit të Thesarit. Në një postim në "Facebook", ajo tha se marrëveshja "mund të sjellë sukses për të dyja vendet tona" dhe "do të tërheqë investime globale në shtetin tonë".

Svyrydenko theksoi se fondi do të financohet ekskluzivisht nga të ardhurat e licencave të reja - përkatësisht 50 për qind nga licencat për materiale kritike dhe projekte të naftës dhe gazit - që do të hyjnë në buxhetin e Ukrainës sapo të themelohet fondi.

Përtej aspektit financiar, Ukraina e sheh këtë marrëveshje si çelës për sigurimin e ndihmës së mëtejshme ushtarake nga ShBA-ja. "Përveç kontributeve financiare direkte, kjo mund të sjellë edhe ndihmë të re - për shembull sisteme mbrojtjeje ajrore për Ukrainën", shkroi ajo në platformën X (ish-Twitter).

Ajo shtoi se marrëveshja është në përputhje me Kushtetutën e Ukrainës, dhe nuk ndryshon kursin e integritetit evropian të Ukrainës. Po ashtu, theksohet se të gjitha burimet natyrore në territorin dhe ujërat territoriale të Ukrainës i përkasin Ukrainës, dhe se vetëm Kiev do të vendosë se çfarë dhe ku do të nxirret.

Qeveria ukrainase e miratoi marrëveshjen më 30 prill, duke i dhënë autorizimin Svyrydenkës për ta nënshkruar atë në



Uashington. Marrëveshja duhet ende të ratifikohet nga Parlamenti ukrainas për të hyrë në fuqi.

Departamenti amerikan i Thesarit deklaroi se do të punojë me Korporatën Amerikane për Financimin e Zhvillimit Ndërkombëtar (DFC) dhe me Qeverinë e Ukrainës për të finalizuar zbatimin e programit dhe për të avancuar partneritetin.

Duke folur më herët, më 30 prill, për televizionin ukrainas, kryeministri ukrainas, Denys Shmyhal, e quajti marrëveshjen "me të vërtetë një marrëveshje të mirë, të barabartë dhe të favorshme për investime të përbashkëta në zhvillimin dhe rindërtimin e Ukrainës".

Në platformën Telegram, Shmyhal sqaroi se secila palë do të ketë të drejtë vote prej 50 për qind në Fondin e Rindërtimit, dhe fitimet e fondit do të riinvestohen

ekskluzivisht në Ukrainë.

Për të adresuar një shqetësim kyç të Kievit, ai theksoi se Ukraina nuk do të detyrohet të paguajë asnjë "borxh" për miliardat e dollarëve ndihmë që ka marrë nga ShBA-ja që nga fillimi i pushtimit rus, në shkurt të vitit 2022.

Trumpi pati deklaruar në shkurt se dëshiron qasje në mineralet e rralla të Ukrainës si kusht për mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së, duke e përshkruar këtë si një mënyrë kompensimi për ndihmën financiare që ShBA-ja i ka dhënë Kievit.

Por, bisedimet ngecën pas një takimi të tensionuar në Zyrën Ovale të Shtëpisë së Bardhë në Uashington, që përfundoi me përplasje verbale midis presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, Trumpit dhe nënpresidentit JD Vance. ShBA-ja kërkon qasje në më shumë se 20 lëndë të para që i konsideron me rëndësi

strategjike, përfshirë depozitat e titanit (që përdoret për krahët e aeroplanëve dhe prodhim të pajisjeve ajrore) dhe uranimit (që përdoret për energji bërthamore, pajisje mjekësore dhe armë). Ukraina gjithashtu ka rezerva të litiumit, grafitit dhe manganit - përbërës kyç për bateritë e makinave elektrike.

Trumpi tha se marrëveshja "në teori" nënkupton se ShBA-ja do të përfitojë më shumë nga Ukraina sesa ka dhënë. "Desha të jem i mbrojtur", tha ai në një intervistë për NewsNation, duke shtuar se nuk donte të dukej "naiv" pa marrë kompensim për investimin. Më herët, në një mbledhje të kabinetit, Trump pati deklaruar se prania amerikane "do të mbajë jashtë vendit shumë aktorë të këqij - ose të paktën larg zonës ku do të bëhet nxjerrja".

Pas rrjedhjes së bisedave sekrete, këshilltari i Trumpit për sigurinë kombëtare largohet nga pozita

UASHINGTON, 1 MAJ - Këshilltari i Sigurisë Kombëtare i ShBA-së, Mike Waltz, ka dhënë dorëheqje nga roli i tij. Mediet raportojnë se zëvendësi i tij, Alex Wong, gjithashtu do të largohet nga pozita. Kjo vjen disa javë pasi Waltz mori përgjegjësinë për një bisedë në grup, në të cilën zyrtarë të lartë planifikuan sulme ushtarake në Jemen, në shoqërinë e një gazetari, i cili ishte shtuar pa dashje.

Ky është anëtar i parë i rëndësishëm i administratës që largohet gjatë mandatit të dytë të Trumpit.

Michael Waltz, ishte këshilltari i



sigurisë kombëtare i Donald Trumpit. Ai ishte ndër emërimet e para të Trumpit pas

zgjedhjes së tij. Përpara rolit në Shtëpinë e Bardhë, ai ishte kongresmen nga distrikti i

gjashtë kongresional i Floridës nga viti 2019 derisa dha dorëheqje në janar për të marrë përsipër detyrën e re me Trump. Në Kongres ai shërbeu në komitetet e Inteligjencës, Shërbimeve të Armatosura dhe Punëve të Jashtme. Ai më parë ishte oficer në Ushtrinë dhe Gardën Kombëtare të ShBA-së. Në fund të marsit, kryeredaktori i revistës "Atlantic", Jeffrey Goldberg, raportoi se ishte shtuar aksidentalisht në një bisedë në Signal nga një përdorues me emrin Mike Waltz.

Në këtë bisedë ishin zyrtarë të

lartë të administratës, të identifikuar si zëvendëspresidenti JD Vance dhe sekretari i Mbrojtjes, Pete Hegseth.

Goldberg thotë se pa plane ushtarake të klasifikuara për sulme ajrore amerikane në Jemen, duke përfshirë paketa me armë, objektiva dhe kohëzgjatje, dy orë para se të bien bombat.

Fillimisht, Waltz tha se nuk e dinte se si Goldberg u përfshi në bisedë, por mori "përgjegjësinë e plotë" në një intervistë me "FoxNews", pasi tha se ai ishte personi që "e ndërtoi grupin".

KROACIA: SHTETE TË BE-së E NATO-s MUND T’I BASHKOHEN ALEANCËS USHTARAKE, VEÇMAS ATA QË DUAN T’U JAPIN PËRKRAHJE KOSOVËS E SHQIPËRISË

PRISHTINË, 1 MAJ - Marrëveshja e përbashkët e nënshkruar në mes të Kroacisë, Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e bashkëpunimit ushtarak ka nxitur reagime të shumta, sidomos nga Serbia. Ka pasur përfolje edhe për rritjen e numrit të shteteve që do t’i bashkohen kësaj iniciative. Më së shumti është folur për Bullgarinë, gjë që ka nxitur edhe polemika, megjithatë Sofja zyrtare e ka mohuar.

Lidhur me gjithë këtë situatë të krijuar, në një përgjigje për “Express” kanë folur nga Ministria e Mbrojtjes e Kroacisë.

Nga Zagrebi zyrtar kanë thënë për “Express” se iniciativa është hapur për të gjithë partnerët në BE dhe në NATO, veçanërisht ata që janë të interesuar t’i ndihmojnë Kosovën dhe Shqipërinë në rrugën e integritimit.

Ndihmesa mund të jepet sa iu përket ekspertizave, zhvillimit të aftësive dhe ndërveprimeve mes forcave të armatosura dhe përpjekjeve në fushën e industrisë së mbrojtjes. “Siç e ka komunikuar disa herë për publikun Ministria Kroate e Mbrojtjes, Deklarata e Përbashkët e nënshkruar nga Republika e Kroacisë, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës është e hapur për të gjithë aleatët dhe partnerët në mjedisin e BE-së dhe NATO-s, veçanërisht për ata që janë të interesuar të ofrojnë mbështetje aktive për Kosovën dhe Shqipërinë në rrugën e tyre euroatlantike, përmes transferimit të përvojës dhe ekspertizës, zhvillimit të aftësive dhe ndërveprimit të forcave të armatosura, dhe përmes sinergjisë së përpjekjeve në fushën e industrisë së mbrojtjes”, kanë thënë për “Express” nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kroacisë.

Për shkak të reagimeve të shumta që ishin nxitur nga kjo marrëveshje dhe për shkak të deklarimeve që vinin nga



Serbia, të tria shtetet kanë publikuar të plotë tekstin e marrëveshjes për bashkëpunim ushtarak.

Teksti i deklaratës:

1. Promovimi i kapaciteteve mbrojtëse dhe bashkëpunimi për industrinë përkatëse duke: Eksploruar zhvillimin dhe blerjen e kapaciteteve mbrojtëse nëpërmjet zgjidhjeve të bashkëpunimit shumëkombësh për të rritur gatishmërinë e forcave tona ushtarake; Identifikuar hapësira për bashkëpunimin industrial të mbrojtjes, duke nxitur aksesin në burime dhe zinxhirë furnizimi për të krijuar një industri konkurruese dhe të qëndrueshme të mbrojtjes; Rritur përpjekjet për të investuar në teknologji dhe inovacione të reja për të përsheptuar dhe siguruar një qasje të unifikuar ndaj transformimit të sigurisë dhe

mbrojtjes.

2. Rritja e ndërveprueshmërisë nëpërmjet edukimit, trajnimeve dhe stërvitjeve duke: Ndarë ekspertizën dhe praktikën më të mira në rekrutimin, zhvillimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar, duke përfshirë shkëmbimin e koncepteve të forcave rezerviste, për të rritur kapacitetet tona parandaluese dhe mbrojtëse; Rritur mundësitë e edukimit dhe trajnimit individual dhe kolektiv përmes akademive dhe kolegjeve ushtarake përkatëse, me qëllim që të ketë kuptueshmëri më të mirë nga ana strategjike të kërcënimeve dhe sfidave të përbashkëta; Forcuar stërvitjet dypalëshe dhe/ose trepalëshe për të përmirësuar ndërveprueshmërinë, në përputhje me Politikën e NATO-s dhe BE-së për Trajnime dhe Stërvitje, për t’u siguruar që forcat të jenë të përgatitura në mënyrë adekuate.

3. Kundërpërgjigja ndaj

kërcënimeve hibride dhe rritja e qëndrueshmërisë duke: Forcuar hapat e përbashkët për t’iu kundërpërgjigjur kërcënimeve hibride, duke përfshirë kërcënimet kibernetike, fushatat e dezinformimit, si dhe ndikimin dashakeq të huaj që mund të komprometojë ose të ndikojë në sigurinë kombëtare dhe rajonale; Shkëmbyer informacione dhe shërbime të inteligjencës për ndërgjegjësimin dhe koordinimin strategjik dhe operacional të situatës ndërmjet institucioneve të mbrojtjes për të parandaluar, zbuluar dhe reaguar në mënyrë efektive kundër sfidave që hasin vendet tona përkatëse; Eksploruar opsione të reagimit që adresojnë një gamë të gjerë kërcënimesh të mundshme për infrastrukturën tonë kritike dhe rrjetet e komunikimit dhe që mbështesin kohezionin dhe ndihmën e ndërsjellë.

4. Ofrimi i mbështetjes së plotë për integrimin euroatlantik duke: Përafuar politikën dhe

pozicionet me institucionet dhe strukturat shumëpalëshe euroatlantike për sigurinë dhe mbrojtjen, për të çuar përpara interesat dhe objektivat tona kombëtare dhe të përbashkëta rajonale; Treguar angazhim për bashkëpunim dhe koordinim më të ngushtë për integrimin e plotë të Kosovës në iniciativat rajonale për sigurinë mbrojtjen; Mbështetur perspektivën euroatlantike të Kosovës duke ofruar mbështetje për statusin e saj në Partneritetin për Paqe të NATO-s.

Kjo Deklaratë e Përbashkët është bërë në frymën e miqësisë, solidaritetit dhe besimit të ndërsjellë. Ajo pasqyron vizionet e përbashkëta strategjike të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Kosovës. Ajo nuk krijon asnjë detyrim të ri ligjor ndërkombëtar ose ndërqeveritar ndërmjet shteteve, as nuk ndikon në detyrimet ekzistuese me shtetet e tjera.

Verrat e Llukës mbeten kujtesë dhe frymëzim për brezat që vijnë



DEÇAN, 1 MAJ - Të enjten në Deçan u mbajt manifestimi për kujtimor kushtuar një prej ngjarjeve më të rëndësishme të historisë sonë, Kuvendit të Pajtimit të Gjaqeve, simbol i unitetit, urtësisë dhe vlerave kombëtare. Në kuadër të këtij manifestimi u bë edhe zbulimi i pllakës përkujtimore, për të nderuar përjetësisht rolin e

këtij kuvendi historik dhe veprën e atyre që kontribuan në misionin e madh të pajtimin. Pjesë e kësaj dite domethënëse ishte edhe një manifestim me fjalë rasti, ku u theksua rëndësia e trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore të këtij vendi, si dhe ndarja e mirënjohjeve për individë që kanë dhënë kontribut të veçantë në

ruajtjen dhe promovimin e këtyre vlerave. “Falënderim për të gjithë pjesëmarrësit, bashkorganizatorët dhe qytetarët që me praninë e tyre e bënë edhe më të fuqishëm mesazhin e paqes dhe bashkimit. Verrat e Llukës mbeten kujtesë dhe frymëzim për brezat që vijnë”, ka thënë kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj.



S'KA KONSTITUIM TË KUVENDIT AS NË PËRPPJEKJEN E NËNTË

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar ta konstituojnë Kuvendin e Kosovës të enjten, në përpjekjen e nëntë, pasi nuk kaloi propozimi i kryesuesit të seancës, Avni Dehari, për votim të fshehtë për kryeparlamentarin. Ndryshe nga herët e kaluara, nuk u propozua kandidati për kryetar të Kuvendit nga partia fituese e zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje. Përpjekja e radhës për konstituimin e Kuvendit të Kosovës do të bëhet të shtunën e 3 majit

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 1 MAJ - Deputetët dështuan për të nëntën herë radhazi në përpjekjen e tyre për ta konstituuar Kuvendin e Kosovës.

Më 1 maj kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari nga Lëvizja Vetëvendosje (LV), kërkoi që votimi për kryetar të Kuvendit të bëhet në mënyrë të fshehtë, por u refuzua nga partitë e tjera.

Përpjekja e radhës për konstituimin e Kuvendit të Kosovës do të bëhet të shtunën e 3 majit.

Procesi ka ngecur prej javësh pasi partia fituese, LV, nuk po arrin t'i sigurojë votat e nevojshme për kandidaten për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu. Ajo shihet nga disa parti parlamentare si "figurë përçarëse", por Vetëvendosje ngul këmbë se ajo është kandidate meritorë.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Hekuran Murati, ka thënë se me refuzimin për votim të fshehtë për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për

Ardhmërinë e Kosovës (AAK) u panë se janë "kundër zhbllokimit, kundër konstitutimit të Kuvendit". Murati ka deklaruar para gazetarëve se votimi i fshehtë për konstituimin e Kuvendit u mundësua nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese më 2014. "PDK, LDK, AAK dhe Lista Serbe refuzuan ta zhblllokojnë procesin", u shpreh Murati.

Ai i ka quajtur "joracionale" qëndrimet e partive që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë.

Murati ka thënë se partia e tij nuk tërhiqet nga qëndrimi se

Albulena Haxhiu duhet të votohet për kryetare të Kuvendit.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka folur para medieve pas dështimit të përpjekjes së nëntë për konstituimin e Kuvendit. Ai ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje (LV) e Albin Kurtit "ka vendosur ta vazhdojë talljen", teksa ka thënë se me propozimin për ndërrim të formës së votimit LV-ja ka bërë "shkelje të hapur kushtetuese".

Krasniqi ka përsëritur qëndrimin e partisë së tij kundër votimit të propozuarës së LV-së për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu. "Nuk kalon Albulena Haxhiu dhe pikë", është shprehur Krasniqi. Ai ka pyetur se çfarë borxhi i ka Kurti Haxhiut që nuk po ndryshon emrin e kandidatit për kryetar të Kuvendit, siç

kanë kërkuar partitë e tjera. Krasniqi ka thënë se Kurti po e konsideron më të rëndësishme Haxhiun sesa Kuvendin e Kosovës.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka shprehur qëndrimin e tij pas dështimit të radhës për konstituimin e Kuvendit të Kosovës.

Nëpërmjet një shkrimi në "Facebook", Abdixhiku e ka akuzuar Lëvizjen Vetëvendosje (LV) për veprim me "arbitraritet të plotë", pas propozimit për ndërrim të formës së votimit për kryeparlamentarin. "A po e kuptoni tani, se pse me të tillët, nuk mund të kesh as takim e as mirëkuptim? Të takojnë, të mashtrojnë! Gjersa të thërrasin në takim, jashtë të ofendojnë. Në fund veprojnë në arbitraritet të plotë!", është shprehur ai. "Sepse nuk njohin njerëzoren, as fjalën as kurrizin! Kjo politikë duhet të

marrë fund! LDK do t'i japë fund!", ka shkruar Abdixhiku, duke shtuar se është interes kombëtar refuzimi i qasjes së tillë politike, jo nënshtrimi e dorëzimi para saj. "Shpresoj dhe partitë tjera ta kuptojnë këtë gjë sa më parë. LDK e ka të qartë. Prandaj është konsistente. Para, gjatë e pas zgjedhjeve. Prandaj votuesi e mbështetësi i LDK-së sot rri krenar!", ka përfunduar Abdixhiku. Edhe deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka folur para medieve pas dështimit të radhës për konstituimin e Kuvendit të Kosovës. Ajo ka thënë se sot "u bë edhe një shkelje tjetër kushtetuese, ligjore, me arbitraritet u tentua të ndryshohet mënyra e votimit". "Rregullorja e

Kuvendit përcakton mënyrat e votimit... Kjo përcaktohet në fillim të procesit", është shprehur ajo. Bajrami ka thënë se "asnjëherë në histori nuk ka ndodhur të ndryshohet procesi, dhe është shkelje që mënyra e votimit të ndryshohet pasi ka filluar procesi". Deputetja e LDK-së ka thënë se partia e saj sot nuk mori pjesë në takimin e ftuar nga kreu i LV-së, Albin Kurti, pasi "nuk dëshiron të ketë një marrëveshje politike me LV-në". Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se konstituimi i Kuvendit të Kosovës është "i vështirë të bëhet pa marrëveshje politike koalicioni, që përcakton shumicën parlamentare". "Ajo shumicë zgjedh kryetarin e Kuvendit dhe qeverinë", është

shprehur ai para gazetarëve. Limaj ka thënë se një "marrëveshje politike duhet të ndërtohet para futjes në Kuvend". "Po pres dhe po besoj që kjo shumë shpejt do të ndodhë", ka deklaruar ai. Drejtori i Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED), Lulzim Peci, ka thënë se përpjekja e Lëvizjes Vetëvendosje që të bëjë "akrobacione me mënyrën e votimit për kryetarin e Kuvendit paraqet aktin e fundit të humbjes së besimit dhe kuptueshmërisë së dialogut politik për tejkalimin e krizës së tanishme". Sipas tij, mënyra e votimit nuk e zgjidh krizën, por këtë mund ta bëjë vetëm marrëveshja politike. "Imponimi nuk zgjidh asgjë, përkundrazi tregon moskapacitet për

marrëveshje! E drejta për të propozuar nuk nënkupton të drejtën e zgjedhjes", shkroi Peci në "Facebook". Peci ka vlerësuar se "është koha e fundit që të kërkohet interpretim nga Gjykata Kushtetuese për ta tejkaluar këtë bllokadë". Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), i cili monitoron punën e Kuvendit të Kosovës, ka shprehur "shqetësim të thellë" lidhur me zhvillimet e sotme në vazhdimin e seancës konstitutive. "Ndryshimi i mënyrës së votimit në mes të seancës, në mënyrë arbitrare nga kryesuesi dhe pa bazë në Rregulloren e Punës së Kuvendit, përbën shkelje të parimeve procedurale dhe një precedent të rrezikshëm për funksionimin e Kuvendit", thuhet në një reagim të KDI-së në "Facebook". "Ky veprim jo

vetëm që bie ndesh me standardet e një legjislature demokratike, por minon edhe besimin publik në rregullsinë dhe integritetin e proceseve parlamentare", thekson KDI. "Çdo përpjekje për të ndryshuar rregullat gjatë lojës - veçanërisht kur vjen në funksion të kalkulimeve të brendshme politike - dëmton rëndë autoritetin e Kuvendit", thuhet më tutje në reagim. "KDI fton kryesuesin e seancës, z. Dehari, dhe të gjithë deputetët, e në veçanti grupin parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, që të respektojnë standardet procedurale të përcaktuara në Rregullore dhe të veprojnë në përputhje me normat e përgjegjësisë institucionale dhe politike që i kërkon funksioni përfaqësues", përfundon reagimi i KDI-së.



TAKIMI KURTI - KRASNIQI, PA MARRËVESHJE

Një orë e gjysmë para fillimit të seancës, kryetari i LV-së, Albin Kurti dhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, kanë zhvilluar një takim në ambientet e Kuvendit, por që rezultoi pa një marrëveshje për zgjedhjen e kryeparlamentarit. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka

folur para medieve pas takimit që ka zhvilluar me kreun e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. "Kemi shkëmbyer ide dhe diskutime sa i përket konstituimit të Kuvendit. Qëndrimet e Partisë Demokratike dhe të miat janë ato që i dini. Atë që e kam thënë pas çdo dështimi të seancës, ia

kam thënë z. Kurti përsëri. Për PDK-në është me rëndësi të zhblokohet kjo situatë, të konstituohet Kuvendi", ka thënë Krasniqi. Kreu i PDK-së ka bërë me dije se Kurtit i ka sugjeruar "të mendojë për kandidat apo kandidatura të tjera" për kryetar të Kuvendit. "Ne nuk kemi

pasur qëndrim mohues apo bllokues. Nuk na takon neve t'ia zgjedhim kandidatin për kryetar të Kuvendit partisë së parë. S'kemi marrëveshje politike", ka thënë Krasniqi. Ai ka thënë se partia e tij është e gatshme të votojë "një figurë që mund të jetë e pranueshme". "Nënkryetarët as që

diskutohen, as që lidhen me diskutimin për kryetar", ka theksuar ai. Krasniqi nuk ka pranuar të tregojë se çfarë i ka thënë Kurti në përgjigje. Sipas Krasniqit, nëse Kurti do që ta zhblokojë situatën, duhet ta ndërrojë sot emrin e kandidatit për kryetar të Kuvendit.

AVOKATI I POPULLIT I KËRKON ZRRE-së T'I PEZULLOJË VENDIMET PËR RRIJTJEN E ÇMIMIT TË RRYMËS

PRISHTINË, 1 MAJ - Institucioni i Avokatit të Popullit i ka kërkuar të mërkurën Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) t'i pezullojë vendimet për rritjen e çmimit të rrymës deri në përfundimin e hetimeve lidhur me ankesat e qytetarëve.

Rregullatori i energjisë e miratoi më 11 prill rritjen e çmimeve për tarifën e energjisë elektrike për 16.1 për qind për amvisëri dhe biznese që kanë deri në 50 punëtorë, duke nxitur protesta. Tarifën e reja u miratuan më 16 prill dhe do të hyjnë në fuqi nga 1 maji.

Në një reagim në "Facebook", Avokati i Popullit tha se rritja e tarifave ka ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat themelore të njeriut, "duke rënduar veçanërisht grupet më të cenueshme dhe familjet në asistencë sociale". "Kjo situatë ngrit shqetësime serioze për përballeshmërinë ekonomike të qytetarëve dhe qasjen e barabartë në shërbimet bazë", thuhet në reagim.

Avokati i Popullit, gjithashtu, tha se rregullatori i energjisë i mori këto vendime "në mungesë të koordinimit institucional" në një kohë kur vendi ka qenë në proces të formimit të institucioneve të reja, pas zgjedhjeve të 9 shkurtit. Kosova ende nuk i ka formuar institucionet e reja për shkak se procesi ka ngecur në konstituimin e Kuvendit prej 15 prillit. "Këto vendime janë marrë në një moment boshllëku institucional - pa Kuvend të konstituuar dhe pa Qeveri të mandatuar, gjë që ka ndikuar në mungesën e debatit të nevojshëm publik dhe institucional për çështje që janë me rëndësi jetike për qytetarët", tha Avokati i Popullit.

Avokati i Popullit tha se Qeveria e Kosovës mban përgjegjësi për garantimin e interesit publik, sigurimin e qasjes të barabartë dhe përfshirjen sociale në politikën energjetike.

Ditë më parë Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut e kundërshtoi

ashpër vendimin për rritjen e çmimit të rrymës, duke thënë se "ritja e çmimit të energjisë nuk do të mbetet rast i izoluar, por do të prodhojë rritje të çmimeve të tjera".

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut [KOSTT], Kompania për Distributim të Energjisë Elektrike në Kosovë [KEDS] dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike [KESCO], kërkuar ngritjen e çmimit të tarifave të rrymës për shkak të importit të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së i miratoi kërkesat e tyre, duke argumentuar se rritja e tarifave këtë vit ishte e domosdoshme për shkak të uljes së prodhimit të energjisë, rritjes së konsumit dhe varësisë së madhe nga importet me çmime të larta.

ZRRE-ja bën shqyrtimin dhe caktimin e përvitshëm të tarifave të rrymës, të cilat shpallen çdo vit më 1 prill dhe vlejnë deri më 31 mars të vitit pasues.

Kosova nuk mund ta sigurojë



energjinë e nevojshme për mbi 1.6 milion banorët e saj vetëm me prodhimin nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).

Një nga arsyt është vjetërsia me dekada e termocentraleve "Kosova A" dhe "Kosova B". Prodhim ka edhe përmes burimeve të ripërtërishme, por në sasi më të vogla.

Kosova, viteve të fundit, është përballur me rritje të vazhdueshme të çmimeve të

produkteve dhe shërbimeve.

Shtrenjtimi ka nisur në kohën e pandemisë Covid-19 në vitin 2020 dhe ka marrë hov pasi Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës, më 2022.

Vitin e kaluar, ZRRE-ja e uli çmimin për konsumatorët komercialë dhe industrialë për 3 për qind. Por, një vit më herët, më 2023, tarifën u rritën për 15 për qind për të gjitha kategoritë e konsumatorëve

LIROHEN NGA PARABURGIMI KATËR SERBËT QË U ARRESTUAN PËR ARMËMBAJTJE PA LEJE MUAJIN E KALUAR NË GJAKOVË

PRISHTINË, 1 MAJ - Gjykata Supreme ka marrë vendim, me të cilin i ka liruar nga masa e paraburgimit katër të pandehurit B. R., N. V., P. K. dhe M. S., të nacionalitetit serb, të cilët u arrestuan më 5 prill në Gjakovë, nën dyshimin se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve". Lirimin e tyre e ka konfirmuar zëdhënësjja e Gjykatës Supreme, Antigona Uka-Lutfiu. Gjykata Themelore në Gjakovë më 7 prill 2025 kishte aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore të Gjakovës, duke ua caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje



prej 30 ditësh (secilit veç e veç) katër të pandehurve.

Gjykata kishte njoftuar se të dyshuarit u ndaluan për tejkallim të shpejtësisë dhe

gjatë kontrollit u vërtetua se kanë armë të ftohta. "Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera, ceket se 'ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit me

inicialet B. R., N. V., P. K., M. S., të nacionalitetit serb, me datën 5 prill 2025, në Rr. 'Gasper Karaqi' në Gjakovë, të pandehurit në bashkëkryerje e duke vepruar në kundërshtim me ligjin për armët, posedojnë armë të ftohta, dhe atë një (1) sëpatë, një (1) thikë me këllëf, dhe një (1) thikë sharrë, në atë mënyrë që pas ndalimit nga ana e zyrtarëve policor për shkak se të njëjtit me automjetin e llojit Toyota ngjyrë hiri, i cili drejtohej nga i pandehuri B. R., kishte tejkalluar shpejtësisë në zonën e kufizuar të shpejtësisë dhe pasi ngasësi i veturës gjatë procedimit të rregullt është pyetur nga zyrtarët policor se a posedon diçka ilegale në veturë

i njëjti ishte përgjigjur se nuk ka diçka të jashtëligjshme me vete, ku edhe kishte shprehur dëshirën për kontroll të veturës dhe pas një kontrole të veturës nga ana e zyrtarëve policor janë gjetur mjetet e mprehta të cekura me lartë, ku te njëjtat të pandehurit i kanë mbajtur gjatë vizitës në mënyrë të organizuar në disa nga Manastiret Ortodokse në Republikën e Kosovës", thuhet në njoftim.

Me këto veprime dyshohen se kanë kryer veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366, par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal. (Betimi për Drejtësi)

Kurti viziton drejtorin e QKUK-së Osman Hajdarin, dënon sulmin ndaj tij

PRISHTINË, 1 MAJ - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka vizituar Osman Hajdarin, ushtruesin e detyrës së drejtorit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Kurti ka dënuar ashpër sulmin ndaj veturës së Hajdarit që ndodhi ditën e mërkurë. "Se krimi i organizuar dhe aksionet me elemente terroriste nuk i trembin drejtorët tanë e dëshmon deklarata publike e djeshme e z. Osman Hajdari, u.d. i drejtorit të QKUK-së. Bashkë me ministrin në detyrë të Shëndetësisë, Arben Vitia, e

takua sot atë si dhe drejtorin e ShSKUK-së, Elvir Azizi. E dënoj ashpër sulmin ndaj drejtorit Hajdari dhe i bëj thirrje organeve të rendit e të drejtësisë që sa më parë të zbardhin rastin dhe kryesit e këtij akti kriminal të sillen para përgjegjësisë", ka pohuar Kurti.

Ai ka shtuar tutje se "në çdo institucion publik kemi ndërmarrë reforma të thella që në thelb kanë mbrojtjen e interesit publik e shërbime më të mira për qytetarët". "Këto reforma kanë prekur interesa të ngushta të klaneve të

ndryshme të instaluara për më shumë se 20 vjet në çdo pore të institucioneve tona", ka theksuar Kurti.

Mes të tjerash, ai shtoi se "akte të tilla jo vetëm që nuk na ndalin, por na bëjnë edhe më këmbëngulës në punët e mira që po bëjmë".

Të mërkurën në parkingun e administratës së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka ndodhur një incident, ku është dëmtuar vetura private e ushtruesit të detyrës së drejtorit të QKUK-së. Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës ka



thënë se dëmtimi ka ndodhur në rrethana ende të panjohura, ndërkaq automjeti

ishte i parkuar në hapësirat zyrtare të administratës në momentin e ngjarjes.

PUNËTORËT NË KOSOVË PROTESTOJNË PËR TË DREJTAT E TYRE, KËRKOJNË RRITJEN E PAGAVE

PRISHTINË, 1 MAJ - Me moton "Qeveri - Kompani, është bërë vonë, kthjelluni ose lamtumirë", Federata Sindikale e Punëtorëve Teknikë të Sektorit Privat të Kosovës ka protestuar në Prishtinë më 1 maj, në Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve. Kreu i Sindikatës, Jusuf Azemi, ka thënë se punëtorët e sektorit privat të Kosovës janë "trajtuar si skllevër" nga ana e institucioneve, duke shtuar se "trajtim të tillë s'ka thujse askund në Evropë".

Pjesëtarët e Sindikatës kanë kërkuar rritjen e pagës në sektorin privat në 600 euro, marrëveshje kolektive, sigurime shëndetësore dhe themelimin e një gjykate të punës. "Ne nuk po mund të mbijetojmë me pagat që i kemi. Në Kosovë punëtorët e sektorit privat edhe sot marrin pagë prej 230 eurosh. Kjo pagë nuk po na lë të vdesim, por edhe nuk po mund të jetojmë", tha Hafije Statovci nga Sindikata. Paga mesatare bruto në Kosovë, sipas të dhënave të fundit të Administratës Tatimore të Kosovës, është 702 euro. Sektori privat llogaritet punëdhënësi më i madh, me mbi 300 mijë të punësuar. Më herët, të enjten, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka



thënë se Dita e Punëtorëve e gjen Kosovën "me probleme të vjetra - vdekje në vendin e punës, ligje të vjetruara, institucione jofunkionale". Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, sipas IKD-së, kanë dështuar t'i ndërmarrin veprimet e duhura në fushën sociale, përfshirë miratimin e zbatimit e ligjeve në këtë fushë. Nëpërmjet një komunikate IKD-

ja ka thënë se Qeveria e Kosovës ka dështuar jo vetëm ta miratojë pjesën më të madhe të ligjeve në fushën sociale, por edhe t'i zbatojë ligjet ekzistuese. "Ligjet bazike si Ligji i Punës, Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë dhe Ligji për Inspektoratin e Punës janë hequr nga agjenda ose kanë mbetur të paadresuara, duke reflektuar mungesë të përparimit dhe angazhimit për çështje

urgjente sociale", thuhet në komunikatë. Në anën tjetër, Kuvendi i Kosovës ka dështuar të zgjedhë një përfaqësues të sindikatave në Bordin e Fondit të Kursimeve Pensionale dhe nuk ka ushtruar në mënyrë efektive funksionin mbikëqyrës ndaj qeverisë. Vetëm gjatë dymbëdhjetë viteve të fundit, sipas statistikave zyrtare dhe të dhënave nga sindikatat, në

vendet e tyre të punës kanë humbur jetën 263 punëtorë, 12 vetëm në vitin 2024, ndërsa në pesëmuajorin e parë të këtij viti ka 10 raste të vdekjes në vendin e punës, ka thënë IKD-ja. Në sheshet kryesore të Prishtinës të enjten protestuan edhe Sindikata e Re e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës, Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist dhe grupi protestues kundër shtrenjtitimit të energjisë elektrike "Asnji cent ma shumë".

Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve - 1 Maji - shfrytëzohet në shumë vende të botës si një ditë për t'i kërkuar të drejtat e punëtorëve, për t'i transmetuar ankesat e përgjithshme ekonomike ose kërkesat politike. Të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë se nga 1.074.704 persona, të cilët janë të moshës së punës - nga 15 deri 65 vjeç - 461 mijë ose 43 për qind janë ekonomiksht aktivë në tregun e punës. Mbi 613 mijë, ose 57 për qind e qytetarëve të moshës së punës nuk janë ekonomiksht aktivë. Shkalla e përgjithshme e papunësisë në Kosovë llogaritet të jetë 10.7 për qind.

TË RINJTË E KOSOVËS PËRBALLË PAPUNËSISË: DIPLOMA NË DORË, PUNË NË SEKTORË TË TJERË

PRISHTINË, 1 MAJ - Në vend që të punojë gjyqtar futbollit, punon ndihmëskuzhinier. Shkëlqim Vllasaliu, 23 vjeç nga Prishtina, është një nga shumë të rinj në Kosovë që kanë vështirësi të ndërtojnë karrierë në profesionin e tyre. Përkushtimi i gjatë, qoftë me ushtrime teorike apo praktike për t'u pajisur me licencë, nuk iu shpërblje për shkak të "shumë sfidave". Pamundësia për t'u angazhuar në këtë profesion, rrethanat, e kanë imponuar të punojë ndihmëskuzhinier në sektorin e gastronomisë, në një restorant në kryeqytet. "Është punë që më lehtë mund të sigurohet, kërkesat janë të mëdha në këtë sektor", thotë Shkëlqimi. Më 1 Maj - Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve, të rinjtë kërkojnë që të gjenden forma për të përkrahur punësimin e tyre, qoftë për punë sezonale, por që edhe pas studimeve të ofrohen mundësi të angazhohen në profesionin e tyre. Në pritje të një pune është edhe Arlind Shala, 23-vjeçar nga Prishtina, i cili ka diplomuar në Administratën Publike në një kolegji privat, në shtator të vitit të kaluar. Punon kamerier në një lokal të Prishtinës. Që nga diplomimi thotë se është interesuar për dhjetëra konkurse në sektorin publik dhe privat, por ka aplikuar vetëm në dy. Ai tregon se nuk ka aplikuar në të gjitha konkurset, pasi shpesh i

është thënë se pa lidhje me ndonjë person në pozita të larta, nuk ka gjasa të pranohet. "Dua të punoj në menaxhimin e analizave, statistikave dhe kontabilitetit, por është shumë e vështirë. Jam zhgënjyer nga sfidat që paraqiten për të punuar në profesionin tim", tha Arlindi, duke shtuar se nepotizmi dhe lidhjet familjare janë faktorët kryesorë për të gjetur punë. Në punë është edhe më 1 maj, kur po shënohet Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve. Një i ri tjetër, Erion Sejdiu, 21 vjeç nga komuna e Ferizajt, në dhjetor të vitit 2024 diplomoi në drejtimin Punë Sociale. Ai priti që diploma t'ia hapë derën drejt profesionit që kishte zgjedhur me pasion. Por, katër muaj më pas, ende nuk ka gjetur një vend pune në fushën për të cilën është kualifikuar, kështu që vazhdon të punojë në sektorin privat. "Aktualisht, jam duke punuar në një profesion krejt të kundërt nga ajo që kam studiuar", tha ai shkurt për Radion Evropa e Lirë. Erioni tregoi se ka pak konkurse për punëtorë socialë - por edhe ato që publikohen kërkojnë minimum tre vjet përvojë në fushë. "Ky kriter pamundëson aplikimin dhe demotivon, zhgënjën një të porsadiplomuar për të ardhmen", tha ai. Në procesin e punësimit te të rinjtë ka sfida të shumta, konsideron Blenda Pira, koordinatore e programeve në organizatën joqeveritare Nisma e



të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë. Pamundësia e tyre për t'u punësuar në profesionin e tyre, ajo shprehet se po i zhgënjën ata dhe po ndikon negativisht në motivimin dhe besimin e tyre për të ardhmen. "Në profesionin e imponuar, edhe puna nuk është cilësore. Të rinjtë disa vite shpenzojnë në shkollim, fakultet, dhe në pamundësi të gjetjes se vendit të punës në profesionin e tyre, detyrohen të punojnë në sektorin e ndërtimtarisë, gastronomisë dhe

sektorë tjerë privatë", tha Pira. Për këtë arsye, ajo konsideron se sistemi i arsimit duhet të ristrukturohet në mënyrë që të përshtaten nevojat e tregut të punës me kuadrot që dalin nga institucionet arsimore. "Ku më mirë do të mund të jepnin kontributin e tyre se në fushën që vetë e kanë zgjedhur të studiojnë të rinjtë dhe të rejtat", thekson ajo. Kjo dukuri vazhdon të mbetet sfiduese për këtë kategori të shoqërisë, thuhet edhe në raportin e Institutit GAP, të

publikuar më 30 prill. "Është e rëndësishme të zhvillohen apo mbështeten programe trajnimi të cilat përgatisin të rinjtë e të rejtat në orientim në tregun e punës. Në Kosovë, trajnime të tilla do të ishin efektive veçmas për të rinjtë që aktualisht nuk janë në arsim, punësim ose trajnim", thuhet në raport. GAP thotë se shumë kompani hasin në vështirësi që kanë të bëjnë me aftësitë e pamjaftueshme të kandidatëve në raport me kualifikimet dhe përvojën që kërkohet.

MISIONI I HRUSHOVIT – LARGIMI I ENVER HOXHËS NGA PUSHTETI

Nga: Elmas LECI

Deri më sot, kur pothuajse kanë kaluar më se 65 vjet nga vizita e ish-kreut të ish-Bashkimit Sovjetik Nikita Hrushov [Khrushchev] në Shqipëri, asnjëherë nuk ka dalë pse-ja e asaj vizite “tollovitëse” më se dhjetë ditore, veçse është thënë e përshkruar rutina e marrëdhënieve dypalëshe sovjeta-shqiptare me “obshet” e kohës. Por, e vërteta ka qenë dhe është krejt ndryshe nga çfarë është thënë deri më sot. Ai, Hrushovi, erdhi në Shqipëri vetëm me qëllimin prima e tepër të fshehtë, të hiqte Enver Hoxhën nga pushteti nga Sekretar i Parë i partisë, si aspekt “i revolucionarizimit” të “stanit” sovjetik të kohës, të bënte atë që kishte bërë në të gjitha vendet e tjera të lindjes komuniste. Duhet thënë se nga studiuesit, heqja e Enver Hoxhës nuk është elaboruar, nuk janë analizuar as format e as mënyrat që përdori Nikita Hrushovi në mbi dhjetë ditë e vizitës në Shqipëri. Ajo që është publikuar dikur me të madhe ishte “mbyllja” e gojës së detyrueshme që Nikita Hrushovi i bëri Enver Hoxhës për Jugosllavinë, duke i thënë madje “urdhëruar” se “duhet ta dish se unë nuk do të flas kundër Titos dhe këtë dua edhe nga ju sa të jem këtu”.

Kjo ishte komunikata e prerë e Nikita Hrushovit ndaj Enver Hoxhës, ende pa i dhënë dorën kur zbriti nga shkallët e aeroplanit në Tiranë. Ky, Enver Hoxha, deri kaq nuk e priste, ndaj aty për aty ia ktheu se “ne mikun nuk e imponojmë”. Ky ishte një lloj “rimiçësimi” i parë, nëse mund të quhet i tillë, disaditor i Enver Hoxhës me Titon. Më se gjashtë vjet me radhë të pushtetit të tij dhe të kohës së reformimit në ish-Bashkimin Sovjetik, Nikita Hrushovi ishte përpjekur ta bindte Enver Hoxhën për “rimiçësim” me Jugosllavinë, por ky nuk po e jepte “okejin”. Është thënë dhe rithënë se “rimiçësimi” me Jugosllavinë, patjetër Enver Hoxhën e largonte nga pushteti, pasi do vinte problemi me zbërthimin e gjërave, ku do t’i dilnin të palarat e qeverimit të tij, do t’i publikoheshin krimet dhe bashkëpunimi në realizimin e terrorizmit në Shqipëri. Mirëpo, Enver Hoxhës, më shumë se çdo gjë i leverdiste mbrojtja dhe mbajtja e pushtetit të tij me çdo kusht sesa reformimi i Shqipërisë sipas qoftë edhe atyre parametrave sovjetikë, aq sa mund të quheshin ato “demokratike”.

Qëllimi i vizitës

Qëllimi apo objeksioni kryesor i vizitës së Nikita Hrushovit, siç e thamë që në fillim, ishte për

largimin e Enver Hoxhës nga pushteti, nga posti i Sekretarit të Parë të Partisë. Hrushovi duhej ta bënte këtë, ashtu siç kishte bërë njëllor edhe me të gjithë Sekretarët e Parë apo ministrat e Brendshëm në vendet e tjera socialiste të Evropës Lindore. Megjithatë, ato që dolën sheshit atëherë, ishin se Nikita Hrushovi e “donte në pakufi Shqipërinë” (i dha në dorë Enver Hoxhës, më 30 maj të vitit 1956, një çek kredie të re prej 500 milionë rublash), ndërsa për trimërim ndaj vendeve të rajonit të Mesdheut ai shpalli ngritjen e një baze nëndetësesh në Butrint, kurse për fuqinë që dispononte BRSS-ja deklaroi se do të instalonte raketa kundër Italisë e NATO-s në territorin shqiptar. Të gjitha ishin, që Enver Hoxha të ndryshonte udhë për “rimiçësimin” me Jugosllavinë dhe në luftën kundër kultit të individit.

Ishin një bonus për të kuptuar se cilët ishin “sovjetikët e rinj” dhe se sa shumë “e donte” Nikita Hrushovi, Enver Hoxhën, ndaj erdhi vetë në Tiranë dhe ndenji jo pak, duke u vërdallitur sa në Jug e në Veri të vendit tonë e duke bërë deklarata që u bënë shkak edhe për aludime jo të pasakta nga perëndimorët deri edhe në shqetësime. Deklaratat e tij nga Butrinti e Vlora, për ngritjen e bazave ushtarake e pajisjen e tyre me armatime moderne e bërthamore, në një kohë që ai propagandonte me të madhe “çarmatimin” e “bashkekzistencën paqësore”, ishin jo vetëm shqetësime, por edhe një nëpërkëmbje e sovranitetit të Shqipërisë, madje pa pyetur fare në prezencë të shtetarëve të saj më të lartë, Enver Hoxhës. Me këto, Nikita Hrushovi “i thoshte” në mënyrë të dhunshme e me shantazh Enver Hoxhës të “qëndronte me tufën”.

Pikëpyetjet e Perëndimit

Nga Perëndimi u bënë në atë kohë shumë pyetje, madje edhe aludime se çfarë bëri aq ditë Hrushovi në Shqipëri dhe çfarë i serviri atij Enver Hoxha gjatë gjithë asaj vizite të stërzgjatur?! Pavarësisht sjelljes “tolerante”, nëse mund të quhet e tillë ajo e Enver Hoxhës në shtëpinë e vet, në mes tyre, Nikita Hrushovit dhe Enver Hoxhës, asgjë nuk ishte aq paqësore, përkundrazi vitet e fundit kishin qenë të mbushura me histori imponimesh e kundërshtimesh, sidomos kur bëhej fjalë për “rimiçësimin” me Jugosllavinë. Në librin e tij “Unë nuk jam gjykatës”, botuar edhe në shqip, të Nikita Hrushovit, ai tregon se si “Enver Hoxha ishte përpjekur t’i imponohej atij që të mos rregullonte marrëdhëniet me



Titon, të prishura që në kohën e Stalinit”. Ndërsa, Enver Hoxha na thotë se “ata që i imponoheshin atij ishin sovjetikët. Ata donin që ne shqiptarët (kupto Enver Hoxhën) jo vetëm t’i zbutnin sulmet ndaj fqinjit verior, por të fillonim dhe të kishim rimiçësim të marrëdhënie me Jugosllavinë”.

Një varg imponimesh dhe kundërthëniesh mund të rizbulohen duke vënë ballë për ballë librat e kujtimeve të Nikita Hrushovit me ato të Enver Hoxhës. Përveç njëmijë e një gjërave të marrëdhënieve në përgjithësi, që ato përmendin e që nisin me qëndrimin ndaj Stalinit dhe që përfundonin tek e ardhmja e Kinës në bllokun komunist, ata të dy, Enver Hoxha me Nikita Hrushovin, sipas kujtimeve të tyre ndaheshin në dy pika: në rimiçësimin me Jugosllavinë dhe në qëndrimin ndaj kultit të Stalinit. Në kujtimet e tij, Nikita Hrushovi shkruan se ai ishte i ndërgjegjshëm që në thelb jugosllavët ishin komunistë të mirëfilltë, kurse në kujtimet e veta po për të njëjtën çështje, të përmbledhura te libri “Hrushovianët”, Enver Hoxha është më shumë se i sigurt për krejt të kundërtën: “Jugosllavët ishin të parët që kishin tradhtuar”.

Raporti i DASH-it

Për vizitën e Nikita Hrushovit në Shqipëri, një funksionar i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit, Spencer Barnes, më 15 qershor të vitit 1959 hartoi një raport shumëfaqësh lidhur me implikimet që shkaktonte ajo vizitë në Shqipëri. Sipas analizës së tij e të disa ekspertëve të tjerë amerikanë, Shqipëria gjithmonë kishte përbërë hallkën më të dobët të formacionit lindor. Kjo edhe për shkak të ambicieve territoriale jugosllave dhe greke, por edhe të interesave

politike italiane. Si rezultat, Shqipëria rrezikohej ose nga një kërcënim i jashtëm ose nga një rebelim i brendshëm sipas modelit hungarez. Një humbje e Shqipërisë do të thoshte një goditje për dinjitetin politik dhe perandorak të Bashkimit Sovjetik, por edhe për vetë prestigjin e Nikita Hrushovit. Për këto arsye, theksonte Barnes, vizita e tij (Hrushovit) në Shqipëri merr një rëndësi të veçantë, jo vetëm simbolike, por mbi të gjitha substanciale. Dhe, kjo u duk, si në nivelin e përfaqësimit të “vizitorëve” këto kohë në Shqipëri (së bashku me Hrushovin ishte i inkuadruar edhe ministri i mbrojtjes, Mareshali Malinovski, e nga ana tjetër në të njëjtën kohë kishte ardhur për vizitë në Shqipëri edhe ministri kinez i Mbrojtjes, Mareshalli Pin De Hua, por kishte edhe ministra të tjerë të Mbrojtjes të vendeve të Lindjes, që u ndodhën ato ditë në Tiranë); vizitë që propaganda e ethshme në median sovjetike si dhe pritjen tejet servile nga Enver Hoxha, i cili ishte një poshtërim, tejkalonte edhe atë të “kultit” të Stalinit. Enver Hoxha, paralelisht me përlulësinë e atyre ditëve (maj-qershor 1959) ndaj Nikita Hrushovit, ndiqte edhe një politikë të brendshëm staliniste, më staliniste se vetë Stalini, me lloj-lloj shtypjesh dhe dhune politike ndaj kundërshtarëve.

Politika e Hrushovit

Nga ana tjetër, synimi i liderit sovjetik ishte që të demonstronte vendosmërinë e Kremlinit për të mbajtur në orbitën sovjetike Shqipërinë, duke e bërë Enver Hoxhën në vepra komplete me Jugosllavinë. Kjo përbente politikën e tij të reformimit (gjatë viteve 1953-1959), që ai u a diktoi të gjithë partive të vendeve të Evropës Lindore. Si rezultat i asaj politike, që pas vitit 1956, në të gjitha vendet e


Evropës Lindore nuk pati më në pushtet asnjë Sekretar të Parë të periudhës së Stalinit. Të gjithë u hoqën apo u dënuan sipas frymës e politikës së re të Hrushovit mbi çrrënjosjen e kultit të individit të Stalinit, pasi edhe ata si Stalini kishin bërë krime, ndaj “rruga e re”, “epoka e re” sovjetike, “kërkonte që në krye të partive të ishin njerëz të rinj, me vizione të reja e jo stalinistë”. Vetëm në Shqipëri u mbeti Enver Hoxha “në derë”. Lidhur me objeksionet e tjera të vizitës së Nikita Hrushovit në Shqipëri, përmendim edhe broçkullat e tij për pëlqimin e ngritjes së bazave ushtarake në Butrint “për të pasur në dorë krejt Mesdheun” dhe për cilësimin e bazës së Vlorës se “me të vinte në zap Italinë e Perëndimin”. Misioni i Hrushovit në Shqipëri, u tha nga analistët Perëndimorë të kohës, lidhej edhe me “bllokadën” e ripërtëritjes të një farë të quajturit Pakti Ballkanik, të arritur disa vite më parë mes Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë.

Ndërsa deklaratat që bënte Nikita Hrushovi nga Butrinti e Gjiri i Vlorës, nga sheshet në Tiranë, apo Korça e Shkodra, ishin për opinionin më së shumti deklarata “burracake” të tij dhe me pasoja plasdarimi, nëse mund të realizoheshin, por u “duartrokitën” dhe u duk se çdo gjë në Shqipëri ishte “shesh-besh”. Natyrisht, për të ardhmen nuk shkoi çdo gjë ashtu siç dukej fasada. Analistët e mprehtë të kohës, dallonin mes rreshtave e qëndrimeve edhe mosmarrëveshjet që ekzistonin, pavarësisht nga deklaratat “epshore” që dukeshin sikur ishin te të dy palët në të njëjtën gjatësi vale.

Marrëdhënia me Enverin

Në marrëdhëniet mes Enver Hoxhës me Nikita Hrushovin, duheshin dalluar shfaqjet nga

thelbi, sepse në dukje ato ishin pritje madhështore e miqësore. Thelbi i tyre gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit, ku ka një sërë dokumentesh tepër sekrete për kohën, në të cilat për ata që dinë t’i lexojnë renditen domethëniet e vizitës së Nikita Hrushovit në Shqipëri. Në fakt, ishin dy: kryesore ishte trysnia e fuqishme ndaj Enver Hoxhës që të ndryshonte qëndrimin ndaj “rimiqësimit” me jugosllavët dhe e dyta, mund të thuhet edhe kjo jo më pak e rëndësishme, ishte po trysnia e pandryshuar me objeksionin kryesor, po mbi Enver Hoxhën, ai i shantazhit ushtarak për ngritjen e bazave raketore. Me të dy këto presione, tërthorazi, por prerë, madje urdhëruese, Nikita Hrushovi kërkonte dorëheqjen Enver Hoxhës. Ishte një përpjekje disavjeçare, që Nikita Hrushovi kishte bërë me shumë tentativa të pafundme, për ta larguar si të gjithë kolegët e tjerë të vendeve socialiste edhe Enver Hoxhën nga posti drejtues. Por, Enver Hoxha, megjithëse ndonjëherë jepte edhe ndonjë shenjë pajtimi drejt lëshimit të postit, duke pranuar “vijën e re” të Hrushovit, por jo, sepse përsëri qëndronte qëndrim i imponuar nga rrethanat e eliminimit. Historia e evolucionit të pushtetit, nga Stalini i vdekur te Nikita Hrushovi, tregoi se ky sapo mori pushtetin, nisi reformimet, ndërmori spastrimet ndaj stalinistëve si Beria, Molotov, Kagonoviq etj. Po si i eliminoi? Amplifikoi gabimet e privilegjet që gëzonin dhe shfrytëzoi edhe cmirat që kishin ndaj njëritjetrit. Në këtë mënyrë, ai ndërmori atë që e quajti “reformimin” e plotë të sistemit despotik stalinist dhe pas veprimeve që ndërmori brenda vendit, me shkarkime e dënime të zyrtarëve më të lartë të BRSS-së dhe deri në “vijën e liberalizimit”, me dënimin e kultit të Stalinit, argumentoi edhe dëmet e jashtëzakonshme që kishte shkaktuar politika despotike e Stalinit. Dhe, pas këtij reformimi, që ishte eliminim i veprimtarive dhe i kultit të individit të Stalinit, Nikita Hrushovi ndërmori reformat në aspektin më të gjerë, në kuadër të gjithë kampit socialist. Para se Hrushovi të vinte në Tiranë, të ngjashmit adashë të Enver Hoxhës për nga posti në vendet e Evropës Lindore, siç theksuam, ishin likuiduar me kohë dhe nga të gjithë ata sigurisht që më i ngjashmi me Enver Hoxhën kishte qenë Rakoshi (më 1956) në Hungari. Ndonëse ai ka qenë shumë më i kulturuar sesa Enver Hoxha, shumë më i ditur dhe me një aktivitet të jashtëzakonshëm politik, rreth gjashtëmbëdhjetë vjet i burgosur politik, me një stazh pranë Stalinit në Moskë dhe drejtues i një plejade njerëzish shumë të kulturuar dhe njohës të thellë të marksizmit, përsëri edhe atë Hrushovi e likuidoi me stimulim dorëheqje.



Metodat e sundimit

Rakoshi me Enver Hoxhën “takoheshin” në një pikë, te sadizmi në metodat e sundimit. Që të dy kishin përdorur doktrinën staliniane që të likuidonin kundërshtarët e tyre. Të dy, sipas Hrushovit, duhej të zëvendësoheshin për të ardhur “të rinjtë”, kudo në ish-vendet socialiste të Evropës Lindore. Pas “dorëheqjes” alla hrushoviane të Rakoshit në Hungari, me këto metoda e “reformime” e gjithë metoda staliniane u godit në të gjitha vendet e Evropës Lindore, madje edhe Rakoshi nuk rezistoi, por iu bind Hrushovit. Ai shkoi në një vend të izoluar të Bashkimit Sovjetik dhe qëndroi atje deri në fund të jetës së tij. Të njëjtën gjë sovjetikët i kërkuan edhe Enver Hoxhës, ta merrnin në Bashkimin Sovjetik e ta mbronin nga përgjegjësitë e krimeve që kishte kryer në periudhën e tij staliniane. Por, ky rezistoi ndryshe nga gjithë të tjerët dhe nuk pranoi të godiste Stalinin. Edhe mitingu i parë masiv u organizua në sheshin para Kombinatit të tekstileve, ku qëndronte hijerëndë monumenti i Stalinit, i veshur me uniformë ushtarake. Nën ndikimin e drejtpërdrejtë të Nikita Hrushovit, udhëheqja e lartë e partisë dhe e shtetit sovjetik e kishin anatemuar politikisht e moralisht Stalinin. Raporti që mbajti në Kongresin 20-të të Partisë Komuniste (Bolshevike) të Bashkimit Sovjetik, në shkurt të vitit 1956, “Mbi kultin e individit të Stalinit dhe pasojat e tij” (të ashtuquajtur sekret), por që u botua në të gjithë shtypin e vendeve perëndimore, ishte më se ndikues në politikën ndërkombëtare. Nikita Hrushovi kishte ngritur një mal me akuza të rënda dhe karakterizimesh negative kundër Stalinit, si “asgjësues moral e fizik” i kuadrove më të rëndësishëm të partisë, të shtetit e të ushtrisë dhe i të gjithë popullit sovjetik. Sipas kësaj, Nikita Hrushovi dhe pasuesit e tij e kishin shpallur publikisht Josif Stalinin si

armikun më të madh të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të popujve sovjetikë. Ndërkohë, në Bashkimin Sovjetik kishte marrë përmasa historike lëvizja për të hequr e shkatërruar ngado bustet dhe monumentet e Stalinit, për t’u hequr emrin e tij ndërmarrjeve ekonomike e kolkozeve bujqësore, institucioneve social-kulturore e qyteteve dhe për t’i ripagëzuar ata me emra të tjerë, të mëparshëm ose të rinj.

Porositë e Enverit


Ndërsa, në antitezë, Enver Hoxha në Shqipëri porosiste skulptorët më të mirë të përgatisnin monumente e statuja për Stalinin. Rreth një vit pasi Nikita Hrushovi kishte dënuar kultin e individit të Stalinit, në vitin 1957 Enver Hoxha inauguroi një monument të ri të Stalinit në qendër të Kuçovës, që në atë kohë quhej Qyteti Stalin. Një relike e këtij monumenti me dorë të shtrirë përpara, ishte vendosur edhe në sheshin para kombinatit të tekstileve në Tiranë. Para tij, Enver Hoxha e “dërgoi” Nikita Hrushovin, pas katër vjetësh që e kishte dënuar e hequr ngado Stalinin, të parakalonte para monumentit në bronz të gjeneralizmit, vetë me pardesy të bardhë. Fjalimi i Nikita Hrushovit, nën hijen e bustit të Stalinit, ishte një provokim i hapur që i bëri Enver Hoxha dhe një domethënie e plotë e mosreformimit të tij sipas “sovjetikëve të rinj”. Ekipit sovjetik të organizatorëve të vizitës së Hrushovit në Kombinat, siç duket nuk u kish shkuar nëpër mend ose më shumë ka të ngjarë që apostafat të mos jetë ndjerë vetë Hrushovi, që donte të thoshte se “as që dua t’ia di për relike” dhe ti Enver Hoxha mbaje “po deshe bustin e Stalinit edhe në oborrin e shtëpisë”. Politikanët dhe diplomatët e vendeve perëndimore, veçanërisht të atyre fqinje, si dekodues profesionistë të kuptimit të modeleve e të sjelljeve joverbale, merrnin

mesazhin se politika e Enver Hoxhës, sa më shumë ecte në binarët e dogmatizmit stalinist, aq më shumë largohej nga realpolitika hrushoviane. Koston e rëndë të politikës staliniste të skajshme të Enver Hoxhës do ta paguante vetëm populli shqiptar, me luftë klasash të ashpër e shkatërrimtare, me varfëri dhe me ritme të ngadalshme zhvillimi, me ngujim dhe mënjanim nga përparimet e vrullshme të shoqërive Perëndimore. Ndërkohë, Hrushovi me ministrin e tij të Mbrojtjes, mareshalin sovjetik Malinovski, vizitonte qytetet periferike, në të njëjtën kohë ndodhej në Shqipëri edhe një delegacion i madh kinez i kryesuar nga Mareshali Pin De Hua, i cili e zhvillonte veprimtarinë e tij kryesisht në kryeqytet (madje u dekorua nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me Urdhrin e Skënderbeut të Klasit të Parë, ndërsa anëtarët e tjerë të delegacionit kinez me urdhra e medalje të ndryshme). Ndërkohë që delegacioni sovjetik lëvizte në linjë partie, kryesisht jashtë kryeqytetit, delegacioni kinez funksiononte në linjë shtetërore. Ndër të tjera, simbolikisht kjo do të thoshte se për të ardhmen, së paku të afërt, në qendër të interesave të Enver Hoxhës nuk do të ishte më si më parë Bashkimi Sovjetik, por Republika Popullore e Kinës. Historia e 20 viteve të pastajme të marrëdhënieve me Kinën, rrodhën tamam sipas një projektimi të shprehur simbolikisht.

Mitingu në Tiranë

Më 30 maj 1959, Enver Hoxha organizoi për nder të Nikita Hrushovit një miting super të madh në sheshin “Skënderbej” në Tiranë. Në fakt, simbolikisht ky miting i përforconte pozitat e “sovjetikëve të rinj” të Hrushovit, dritë jeshile e cila u shua shpejt, sepse të nesërmen, siç e cilësoi shtypi i huaj, Nikita Hrushovi u “arratis” ose më saktësisht e “arratisën” nëpërmjet protokollit, përsëri në qytetet

e krahinat periferike. Një ecuri e tillë simbolikisht përcillte mesazhin se në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike gjithnjë e më shumë po bëheshin mbizotëruese forcat centrifugale, të cilat brenda më pak se dy vitesh do t’i shkëpusnin përfundimisht marrëdhëniet e tyre. Edhe në fjalët e fundit të Nikita Hrushovit, kur u largua nga aeroporti i Rinasit dhe në fjalimin e përcjelljes së tij, që u mbajt nga Enver Hoxha, në dukje nuk viheshin re shenja të mosmarrëveshjeve apo të konflikteve të ashpra që vërtet po thelloheshin mes tyre. Por, të vërtetën e zhbiriluan kameramanët e filmimeve që kanë fiksuar, lëvizje apo gieste të Enver Hoxhës në çastin e largimit të Nikita Hrushovit nga aeroporti i Rinasit, ku ai bëri me dorë një gjest që u interpretua se “shpëtoi nga një e keqe e madhe”. Ishte “e keqja” që Enver Hoxhës i kishte ardhur nga vizitori “i madh” në Tiranë, që i kërkoi t’i bashkohej reformimeve sovjetike, duke pranuar “rimiqësimin” me Jugosllavinë dhe të luftonte “kultin e individit”. Për këto, Enver Hoxhës i kërkoheshin të jepte dorëheqjen e të vijonte edhe në Shqipëri fryma e Kongresit të 20-të të “sovjetikëve të rinj”. Këtë, largimin nga posti, Enver Hoxha nuk e bëri dhe siç e tregonin “bathët” as do ta bënte kurrë, sepse si nuhatës dinak e dinte fare mirë që po ta bënte dorëheqjen, kjo do ishte vetëvrasje, ndaj i qëndroi fort Hrushovit, fillimisht me dredhi që vijoi edhe me vizitën e parë dhe të fundit në Shqipëri dhe pastaj nëpër forume, me ato që u quajtën mosmarrëveshje, të cilat Enver Hoxha i quajti e i “mbrojti si parimore”, por që në fakt ishin mbulim i çështjes që shqetësonte Enver Hoxhën – largimi nga pushteti. Të gjitha këto Enver Hoxha i ktheu në antipod dhe i shfrytëzoi në opinionin e brendshëm dhe të jashtëm si “mbrojtje nga ai të marksizëm-leninizmit”. Në fakt, qëndrimi i Enver Hoxhës nuk kishte asgjë të përbashkët me parimet se ato ai as nuk i njihte pa lere më t’i mbronte, por ishin veç mosmarrëveshje për dorëzimin e pushtetit për të cilën Hrushovi erdhi vetë në Shqipëri. Madje, dorëheqjen ia kërkoi Enver Hoxhës me insistim, me gojë e me shembuj në 10 ditët e vizitës, direkt e indirekt, me diplomaci dhe me shantazh. Por, Enver Hoxha, siç theksojnë shumë e shumë analistë perëndimorë të kohës, arriti të triumfojë e nuk dëgjoi nga ai vesh që i fliste Nikita Hrushovi, por problemet i amplifikojë me të në “mosmarrëveshje gjoja parimore”, por që nuk kishin asgjë parimore, veçse mbajtjen e pushtetit dhe të karriges nga Enver Hoxha. /Gazeta “Panorama”/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Istogu e fiton gjysmëfinalen e parë

Kampioni në fuqi, Istogu, e ka fituar gjysmëfinalen e parë të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Istogu të enjten mbrëma e mposhti Shqiponjën e Gjakovës me rezultat 29:21. Ndeshja u

zhvillua në Banjë. Istogut, që të dielën e fitoi Kupën e Kosovës, i duhet edhe një fitore për kualifikim në finalen e madhe. Ndeshja e dytë zhvillohet në Gjakovë. Shqiponja nisi mirë ndeshjen duke krijuar epërsi 3:0. Istogu barazoi së pari në

minutën e 16-të, 6:6. Sërish Shqiponja ishte në epërsi, ndërsa barazim tjetër u regjistrua në minutën e 24-të, 9:9. Në minutën e 25-të, Istogu për herë të parë doli në epërsi, 10:9, e më pas edhe 11:9. Me një seri golash në fillim të pjesës së

dytë, Istogu u shkëput në 18:13. Dhe më gjakovaret nuk ia dolën të afrohen në rezultat. Suzana Ujkiq i shënoi nëntë gola për Istogun. Tetë i realizoi Sucacuexe Paulo Sebastiao. Alma Nivokazi ishte më efikasja te Shqiponja me 12 gola.



Kastrioti mposhti Besën pas vazhdimeve

“Epoka e re”

FERIZAJ, 1 MAJ - Kastrioti e Besa Famgasi kanë ofruar tjetër ndeshje spektakolare. Të enjten në palestrën “Bill Clinton” në Ferizaj, Kastrioti e Besa u përballën në gjysmëfinale të plejofit të Superligës së Kosovës në hendboll. Për ta vendosur fituesin nuk mjaftuan 60 minuta. U luajtën dy vazhdime nga pesë minuta, ndërsa fitorja në fund i takoi Kastriotit me rezultat 38:37. Kështu ferizajasit kanë bërë hapin e madh drejt finales së plejofit. Për të kaluar në finale, njëra skuadër duhet t'i shënojë dy fitore. Ndeshja e dytë është në fundjavë në Pejë. Besa Famgas ishte në epërsi prej fillimit të ndeshjes. Pas pjesës së parë rezultati ishte 21:18 për ekipin pejan. Edhe në pjesën e dytë lojtarët e Besës ishin vazhdimisht në epërsi, ndërsa Kastrioti vetëm barazonte. Në minutën e 56-të epërsia e Besa Famgasit ishte katër gola, 33:29. Por Kastrioti me dy golat e Deniz Terziqit dhe nga një të Lulzim Shabanit e Beni Sulës, barazoi në 33:33. Me këtë rezultat përfundoi koha e rregullt prej 60 minutash, ndërsa minutat e fundit ishin shumë dramatike. Në



vazhdimin e parë prej pesë minutash të dy skuadrat i shënuan nga dy gola për 35:35. Në vazhdimin e dytë, Besa shënoi fillimisht për 36:35. Kastrioti barazoi në 36:36. Dardan Dugolli më pas priti penallti për të mbajtur skuadrën vendase në lojë. Në anën tjetër të fushës shënoi Deniz Terziqi

për 37:36. Edonis Hajra i Besës shënoi për 37:37, 50 sekonda para fundit. Kastrioti organizoi aksion dhe 20 sekonda para fundit, Besnik Bytyqi shënoi golin e parë personal në ndeshje për 38:37. Në aksionin e fundit mysafirët nuk shënuan dhe kështu festa ishte për lojtarët e Kastrioti dhe mbi 500

shikues që ishin në palestër. Të dielën Kastrioti e Besa Famgasi u përballën në finale të Kupës së Kosovës. Në praninë e 3000 shikuesve, po në “Bill Clinton”, fitore shënoi Kastrioti. Në ndeshjen e së enjtes, Kastriotin e udhëhoqi Deniz Terziqi me 13 gola. Nga pesë i shënuan Lulzim Shabani, Festim Mustafa e

Yassine Henahen. Me pritje të shumta kontribuan edhe portierët Wadi Chebbi dhe Dardan Dugolli. Te Besa Famgas nga tetë gola i shënuan Olsi Mulaj, Jon Vokshi e Balsha Çejoviq. Amar Muqolli e Elion Vokshi i shtuan nga katër, ndërsa pritje të shumta kishte Mursel Mehmeti.

Paraqitje dhe fitore bindëse e Samadrexhës

Me një paraqitje bindëse, Samadrexha e ka mposhtur Ferizajn në ndeshjen e parë gjysmëfinale të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Ndeshja u zhvillua të enjten pasdite në Ferizaj, ndërsa samadrexhaset fituan 31:23. Kësaj skuadre i duhet edhe një fitore për kualifikim në finale të plejofit. Samadrexha e nisi

ndeshjen sigurt dhe në dhjetë minutat e parë krijoi epërsi 7:2. Në minutën e 23-të, epërsia e Samadrexhës u bë dyshifrore, 15:5. Pjesa e parë përfundoi 17:8 për ekipin mysafir. Në pjesën e dytë epërsia shkoi deri në 12 gola, ndërsa në fund dallimi ishte tetë gola. Mirjeta Dinolli u shqua te Samadrexha me dhjetë gola. Gjashtë i kishte Jennifer

Toledo Abreu, ndërsa pesë i realizoi Arlinda Maloku. Te Ferizaj nga pesë gola i shënuan Elsa Kongjeli e Lorena Matarova. Ferizaj e kishte mposhtur Samadrexhën në gjysmëfinale të Kupës, por në gjysmëfinale të plejofit rolet ndryshuan. Ndeshja e dytë është në fundjavë në palestrën “Afrim Bunjaku” në Samadrexhë.





Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 02.05.2025, shpall konkurs të brendshëm për këto vende të punës :

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita : Sigurim i Objektivit (Roje) - 1 pozitë

Vendi punës : Istog
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar
Koeficienti i pagës : 1.8

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Përcjellë hyrje-daljen e palëve, punëtorëve dhe automjeteve;
2. Daljen e punëtorëve pa leje paraprake, të parakohshme i evidenton në libër të veçant;
3. Palët duhet t'i jape fletëhyrjen dhe i orienton për në shërbimet për të cilat janë të interesuara;
4. Është i obliguar për sjellje korrekte me pale dhe për qëndrim në vendin e tij të punës;
5. Bënë sigurimin e objektivit në të cilin është përcaktuar në bazë të planit mujor;
6. Bënë shiqimin e gjendjes së objektivit dhe mjeteve kundër zjarrit dhe rregullësis së tyre;
7. Kontrollon dhe largon personat e paautorizuar dhe të dyshimt që ndodhen afër objektivit.
8. Ndërmerr masat e nevojshme në mbrojtjen e objektivit nga dukurit natyrore dhe për këtë lajmëron menjëherë shërbimet e specializuara;
9. Pranon dhe dorëzon ndërrimin dhe për gjendjen e objektivit e informon punëtorin e sigurimit të radhës;
10. Obligohet që në vendin e punës të mbajë uniformën;
11. Pas orarit të rregullt të punës nuk guxon t'i lejoj hyrjen e personave të pautorizuar, përveç zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes;
12. Është përgjegjës i përgjithshëm i materialit dhe automjeteve, gjatë kohës së orarit të punës, me rastin e marrjes dhe dorëzimit të detyrës;
13. Ndalon personat dhe automjetet e pa autorizuar dhe ndalon huthjen e mbeturinave nga ana e popullatës lokale;
14. Të kryej punë të cilat i besohen mbrenda ditës, të ketë kujdesë në punë në mënyrë që mos të vjen gjerë te ndezja e mbeturinave;
15. Në rast të ndonjë avarie, ta evitojë atë dhe të lajmëroj shefin e sigurimit dhe organet Kompetente;
 - o Ndihma e shpejtë - 194,
 - o Emergjencia Civile - 112, 41
 - o Zjarrfikësit - 193,
 - o Policia - 119
16. Të punojë të shtunave dhe të dielave.
17. Kryen pune bazuar ne kontraten e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të shefit të sigurimit;
18. Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Elzskutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV ;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
- Letër motivimi ;
- Kopja e letërnjoftimit ;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- Shkollimin fillor përparësi shkollimi i mesëm;
- Përparësi janë certifikimet në siguri
- Aftësi shumë të mira organizative
- Njohja e punës me kompjuter.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com

Data e për aplikim është nga 02.05.2025 deri me 19.05.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fatbardh Kabashi shpall të pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.

- Arber Kryezi shpall të pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Mustaf Mustafa shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Motrat Qiriaz" Prizren.

- Betim Katana shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Fitnete Neziri shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Ekrem Rexha" Prizren.

- Gezim Kosova shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Motrat Qiriaz" Prizren.

- Ensar Butuc shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Motrat Qiriaz" Prizren.

- Laokont Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Sylja Hodaj B.I. shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr.811142562 të lëshuar nga ATK.

- Leotrim Qevani shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë.

- Ari Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Lirigzon Morina nga Senoci i Rahovecit shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e shkollës së mesme profesionale "Selajdin Mullaabaz-Mici", Rahovec.

- Fadil Dujaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Besart Bardhi nga Tropoja e Shqipërisë shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 12 dhe diplomën e lëshuar nga Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
Since 1909
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

